

RADIKA: VETITË ETNOKULTURORE DHE MBROJTJA JURIDIKO-NDËRKOMBËTARE E SAJ

Hyrje

Punimi synon të hedh dritë mbi një trevë me vlera etnokulturore dhe hirdroteknike, me prurje në fushën e faunës, florës, ekosistemit, si dhe të një tradite juridiko-historike tepër të spikatur për këtë trevë, sikurse është zona e Radikës, si dhe vetë lumi Radika, e cila përbëri shtyllën kryesore të debatit të Komisionit të Konvetës së Bernës, Zvicër.

Pellgu ujëmbledhës i lumit Radika ose Artatus⁽¹⁾ hyn në zonën klimatike të "Viseve malore" e cila karakterizohet me klimë tipike malore që shoqërohet me rreshje të mëdha atmosferike (1300-1800 mm në vit) me verë të shkurtër dhe të freskët, dimra të ftohtë dhe me sasi të mëdha rreshesh bore.

Në gjithë zonën mbizotërojnë erërat që fryejnë nga veriu, veri-lindja dhe jug-lindja. Temperatura e ajrit mesatare vjetore në pjesën e sipërme të pellgut shkon nga 2°C deri në 6°C, në pjesën e mesme 7°C deri në 10°C. Vlerat e temperaturës maksimale arrijnë nga 30°C deri në 35°C, ato minimale arrijnë deri në - 30°C, ndërsa në pjesën e mesme dhe të poshtme të pellgut ato shkojnë nga - 18°C deri në - 25°C.

Kësisoj, mbi ujrat e Radikës, Konventa vendos parimin e "përdorimit të arsyeshëm dhe të ndershëm" dhe rrjeshton një sërë faktorësh për të përcaktuar këtë përdorim. Ajo nxit shtetet të hyjnë në marrëveshje të përbashkëta për ujërat, duke rekomanduar krijimin e komisioneve të përbashkëta për të lehtësuar bashkëpunimin mes zonave ndërkufitare.

¹ Prof. Dr. Kadiu, A. "Dibra e Madhe dhe një vështim në Dibrën e Vogël", Monografi, Tiranë 2010, fq.16

Konventa për Mbrojtjen dhe Përdorimin e Ujërave Ndërkombëtar e Komisionit Ekonomik Evropian të Kombeve të Bashkuara (KKEKB ose UNECE në anglisht) – që ndryshe njihet si Konventa e Ujit e Helsinkit e vitit 1992, është një instrument ligjor unik që merret kryesisht dhe përcakton mekanizmat për bashkëpunimin institucional ndërmjet shteteve. Kjo konvente u bë pararojë për mbrojtjen e lumit Radika si dhe të florës, faunës, rreqebullit ballkanit dhe etnokulturës së saj.

Konventa e Bernës

Në raportin e komitetit të Bernës në lidhje me këtë shkruhet: “Qëllimi kryesor i kësaj direktive (DTU- BE) është parandalimi i përkeqësimit të cilësisë së ujërave dhe mbrojtja e eko-sistemeve aktuale dhe të atyre eko-sistemeve që kanë lidhje me eko-sistemet aktuale. Duke pasur parasysh masën e madhe të ndryshimeve të karakteristikave biologjike të pasurive ujore që do të cenohen nga ky projekt (Boskov Most), dhe nga fakti që uji do të transferohet nga një basen lumor në një tjetër, është e rëndësishme që të përgatiten raportet vlerësuese ambientaliste duke i dhënë vëmendjen e duhur kësaj direktive të rëndësishme të legjislacionit evropian.”

Kësisoj, në lidhje me reagimin e banorëve vendas ndaj këtyre projekteve hidroenergjetike raporti i komitetit të konventës së Bernës vazhdon; “Ka një ndryshim themelor në perceptimin e këtyre projekteve të ndërtimit hidroenergjetike në mes komunave të ndryshme.

Ndërsa ato që janë të shtrira në park, dhe që janë përfshirë në proces dhe do të kompensohen, e pranojnë projektin (Boskov Most) dhe vlerësojnë anët e dobishme, të tjerët poshtë rrjedhës së lumit dhe jashtë parkut ankohen për marrjen e ujit dhe mungesën e pjesëmarrjes në planifikimin e projektit.

Në rekomandimet e komitetit për qeverinë maqedonase në mes të tjerave shkruhet: “Përpara se të ndërmerret ndonjë projekt ndërtimi hidroenergjetik, nga autoritetet qendrore apo lokale, duhet të kryejë një studim vlerësimi të integruar strategjik të pasojave ekologjike dhe shoqërore, duke shqyrtuar të gjitha aktivitetet e planifikuara dhe duke përfshirë komunitetet e ndikuara vendase jashtë parkut si dhe ato ndërkombëtare, kryesisht ato në regjimet ujore të lumenjve Drin dhe Vardar; të

plotësojë këtë studim me dispozitat e Direktivës Themelore të Ujit të Bashkimit Evropian.”

Rekomandimet e komitetit të konventës së Bernës janë konfirmimi më i plotë i kauzës së drejtë të organizatave ambientaliste të Maqedonisë dhe të Shqipërisë si dhe ato ndërkombëtare, i banorëve dhe drejtuesve të komunave të prekura nga projektet si ajo e Dibrës, dhe në mënyrë jo të drejtpërdrejt edhe të autorëve të këtij libri të cilët, gjatë gjithë kohës, kanë argumentuar kundër këtyre projekteve.

Kuadri juridiko-ndërkombëtar për mbrojtjen e ujrave ndërkufitar.

Para vitit 1992, gjendeshin vetëm gjashtë basene lumenjsh ndërkombëtare në Ballkan, por pas shpërbërjes së Jugosllavisë numëri u dyfishua. Tashmë ekzistojnë 13 pellgje të përbashketa lumenjsh ndërkombëtare dhe katër basene liqenesh ndërkufitarë.

Traktatet zakonisht krijuan komisione të përbashkëta, disa nga të cilat akoma funksionojnë. Komisioni për Danubin, për shembull, u krijua sipas Konventës së Beogradit për Rregjimin Lundrues të Danubit në 1948.

Përpos ujërave ndërkombëtare, ish Jugosllavisë iu desh të administronte ujërat kombëtare që i përkisnin federatave të ndryshme – gjashtë republikave dhe dy provincave autonome. Marrveshjet e ujërave ndërmjet këtyre njësive kishin bazë kushtetuese dhe ligjore.

Një shembull i mirë i këtij lloji instrumenti ligjor është marrveshja që kontrollon përdorimin e pellgut të lumit Trebizat, midis Bosnje Hercegovinës dhe Kroacisë. Edhe është e paqartë se pse një shembull kaq i mrekullueshëm bashkëpunimi ndërshtetëror nuk u vu në zbatim.

Prishja e Murit të Berlinit në 1989 i dha fund ndarjes në Evropë për një bote bipolare. Marrdhëniet e reja i hapën rrugë shumë marrveshjeve multilaterale për mjedisin, ku çështja e ujërave ndërkufitare figuronte në mënyrë konstante. Traktate të reja për të përforcuar një sistem rregullator më të hollsishtëm u nënshkruan në Kiev në 2003.

Kjo është e vlefshme edhe për Konventën Aarhus. Pavarësisht, vendet ballkanike do të përfitojnë nga nënshkrimi dhe miratimi i

traktateve ndërkombëtare të ratifikuara edhe nga BE, veçanërisht që një praktikë e tillë do të fuqizonte politikat e tyre ambjentaliste dhe angazhmin në rang kombëtar dhe për të shërbyer si një platformë për bashkëpunimin ndërkombëtar ndaj dëmeve dhe kanosjeve kundrejt mjedisit.

Konventa e Kombeve të Bashkuara, Ligji i Përdorimeve përveç Lundrimit të Ujërave Ndërkombëtare është një tjetër shembull i mirë ilustrimi. Pranimi i parimeve të këtyre instrumentave ndërkombëtarë për mbrojtjen e ambjentit dhe burimeve ujore, dhe zbatimi i kuadrit përcaktuar nga këto sigurisht që do të sjellë avantazhe, stabilitet dhe siguri në Ballkan.

Plotësimi i kërkesave të BE në lidhje me këtë, varet nga se sa të sukseshëm vendet Ballkanike janë në transformimin e sistemeve të administrimit të ujërave trashëguar nga periudha socialiste. Kjo do të thotë adoptimin e mënyrave të reja dhe në disa pjesë tepër të avancuara të administrimit të ujërave, që përfshijnë bashkëpunimin aktiv me vendet pjesëmarrëse të pellgjeve ujëmbledhëse të lumenjve të përbashkët.

Gjatë 12 viteve të fundit, të gjithë vendet e Ballkanit, përveç Serbisë, kanë aprovuar legjislacion të ri për ujërat, duke zëvendësuar metodat e vjetëruara të administrimit të ujërave dhe përgatitjes për të përballuar sfidat e reja.

Marrveshjet multilaterale për ujërat vënë në jetë nga Komisioni Ekonomik Evropian i Kombeve të Bashkuara: Më poshtë po rendsim disa prej konventave dhe protokolleve më të rëndësishëm.

Konventa mbi Vlerësimin e Pasojave ndaj Ambientit në Kontekstin Ndërkufitar (Konventa Espoo, Espoo 1991)

Konventa Espoo (EIA) përcakton detyrimet e palëve të ndryshme për të vlerësuar pasojat ndaj ambientit për disa lloj aktivitetesh që në fazat e para të projektit. Gjithashtu parashton detyrimet e përgjithshme të shteteve për të lajmëruar njëri-tjetrin për të gjitha projektet madhore në shqyrtim që mund të kenë ndikim të theksuar dëmtues ndaj mjedisit në të dyja anët e kufirit.

Konventa mbi Efektet Ndërkufitare të Aksidenteve Industriale (Helsinki 1992)

Konventa synon të mbrojë qeniet njerëzore dhe mjedisin kundrejt aksidenteve industriale duke parandaluar ngjarje të tilla

me aq sa është e mundur, duke ulur intensitetin dhe ndikimin e tyre dhe duke zbutur pasojat. Ajo nxit bashkëpunim aktiv ndërkombëtar ndërmjet palëve të interesuara, përpara, gjatë dhe pas një aksidenti industrial.

Konventa mbi të Drejtën për Informacion, Pjesëmarrja Publike në Vendim-marrje dhe e Drejta për Ndihmë Ligjore për Çështjet e Mjedisit (Konventa Aarhus, Aarhus 1998)

Kjo Konvente u adoptua nga palët pjesëmarrëse më 25 Qershor 1998 në qytetin danez Aarhus në konferencën e katërt ministeriale si pjesë e procesit “Ambjenti për Evropën’.

Konventa Aarhus është një lloj marrëveshje e re ambjentaliste. Konventa: Lidh te drejtat e njeriut me të drejtat ambjentaliste Pranon si të mirëqenë detyrimin tonë ndaj brezave të ardhshëm. Përcakton që zhvillimi me kriter mund të arrihet vetëm nëpërmjet përfshirjes të të gjithë palëve të interesuara; Lidh përgjegjësitë e qeverisë dhe mbrojtjen e mjedisit.

Përqëndrohet në marrë dhëniet reciproke ndërmjet publikut dhe autoriteteve publike në kontekstin demokratik. Gjithashtu, konventa Aarhus po ngumon në një proces të ri, për një pjesëmarrje të gjerë publike në bisedime dhe në zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare (Pacta Sum Servanta)⁽²⁾.

Konventa Aarhus njeh të drejtat e publikut dhe i kërkon Palëve të interesuara dhe autoriteteve publike që të njohin detyrimet e tyre në lidhje me të drejtën e publikut për informacion dhe pjesëmarrje dhe të drejtën për të përdorur mekanizmat ligjorë.

Konventa Aarhus gjithashtu po kalit një proces të ri për pjesëmarrjen publike në bashkëbisedime dhe zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare.

Protokolli mbi Ujin dhe Shëndetin (Londër 1999)

Synimi i Protokollit është mbrojtja e shëndetit dhe mirëqënies njerëzore nëpërmjet administrimit të mirë të rezervave ujore, duke përfshirë mbrojtjen e ekosistemeve ujore, dhe duke parandaluar, kontrolluar dhe ulur sëmundjet nga uji.

² Pacta Sum Servanta:lat. “Çdo marrëveshje mes palëve, do të realizohet me mirëkuptim reciprok”

Protokolli gjithashtu i hap rrugën pjesëmarrjes të gjerë të publikut në procesin e vendim-marrjes nga ana e qeverisë për shumë sektorë të zhvillimit.

Protokolli mbi të Drejtën për Kompensim për Dëme shaktuar nga Efektet Ndërkufitare të Aksidenteve Industriale në Ujërat Ndërkufitare (Kiev 2003)

Protokolli i njeh të drejtën ligjore për kompensim të plotë dhe të menjëhershëm të gjithë personave ndikuar nga pasojat e aksidenteve industriale me përhapje ndërkufitare (si për shembull peshkatarët ose përdoruesit e impianteve ujore).

Kompanitë do të jenë përgjegjëse për aksidentet në instalimet industriale, përfshirë këtu digat si edhe transportin nëpërmjet tubacioneve. Protokolli cakton masën e përgjegjësisë financiare në varësi nga rreziku i aktivitetit, për shembull sasinë e substancave të rrezikshme që janë ose mund të jenë të pranishme dhe nivelin e toksicitetit ose kanosjen që paraqesin për mjedisin. Për të mbuluar këto përgjegjësi, kompanive do ti duhet të organizojnë siguritë financiare, si sigurimin ose garanci të tjera.

Dëmi fizik, dëmi ndaj pronës, humbje të ardhurash, kostot e rikthimit dhe masat ndihmëse do të mbulohen nga Protokolli. Protokolli siguron jo-diskriminimin e viktimave: viktimat e pasojave ndërkufitare nuk mund të trajtohen me më pak prioritet se sa viktimat në vendin ku ka ndodhur aksidenti. Protokolli plotëson një nga boshlliqet e mëdhaja në legjisllacionin për ambjentin dhe zgjidh problemin e dëmeve të pakompensuara në vendet fqinje.⁽³⁾

Protokolli mbi Rregjistrat e Transferimeve dhe Zbrazjen e Ndohtësve (Protokolli PRTR, Kiev 2003)

Protokolli është instrumenti i parë ndërkombëtar me fuqi ligjore për rregjistrat e transferimeve dhe zbrazjen e ndohtësve. Synimi i tij është 'të zgjerojë mundësinë e marrjes së informacionit nga ana e publikut nëpërmjet krijimit të rregjistrave të qartë mbi zbrazjen kombëtare të ndohtësve dhe transferimeve. Këto rregjista janë inventarë të ndohtëjeve nga zonat industriale dhe burime të tjera.

Megjithëse Protokolli merret me rregullimin e informacionit mbi ndohtëjen, se sa vetë ndohtëjen, miratimi i tij pritet të ulë

³ Sipas parimit romak: "Ex bonus, ex meglis-sipas së mirës dhe të drejtës"

ndjeshëm nivelin e ndohtjes, për arsye se asnjë kompanie nuk i intereson të identifikohet si një nga ndohtësit kryesorë.

3. Marrëveshjet ndërshtetërore për mbrojtjen e ujërave

Përpjekjet e para për kodifikim e ligjit ndërkombëtar për përdorimin e ujërave ndërkombëtare u ndërmor nga Instituti i Ligjit Ndërkombëtar dhe Shoqata e Ligjit Ndërkombëtar (SHLN). Në 1966, kjo e fundit adoptoi Rregullat mbi Përdorimin e Lumenjve Ndërkombëtarë, njohur si Rregullat e Helsinkit.

Ishin këto rregulla që krijuan parimin e “përdorimit të arsyeshëm dhe të ndershëm”. Sipas këtij parimi, çdo shtet i një pellgu ujëmbledhës ka të drejtë” mbrenda territorit të tij, të përfitojë nga përdorimi i ujërave të një pellgu ndërkombëtar në një masë të arsyeshme dhe të ndershme.

Në Rregullat e Helsinkit, parimi i përdorimit të arsyeshëm dhe të ndershëm doli përsipër një norme tjetër të rregjimit ligjor ndërkombëtar të ujërave, parimit të “kundër dëmit serioz”.

Ky i fundit i kërkonte shteteve përkatëse të mos lejonin ndohtjen e ujit ose rritjen e ndohtjes gjë që mund të shkaktonte probleme serioze në shtetin pjesëmarrës në pellgu ujor.

Në 2004, u adoptuan Rregullat e Berlinit për Burimet Ujore, që përbënte një rishikim të atyre të Helsinkit dhe rregullave të vetë shoqatës. Në këtë rast, kjo pjesë e ligjit u plotësua me pjesën për mjedisin dhe të drejtat e njeriut. Mes çështjeve të tjera, ato merren me organizimet institucionale nga shtetet pjesëmarrëse si për shembull “agjenci ose komisione të përbashkëta me autoritetin për të ndërmarr administrimin e integruar të ujërave në një pellg ujërash ndërkombëtar” ose “mekanizma të tjera të përbashkëta”.

Përfundime

Për më tepër, me 9 Dhjetor 2015, BERZH vendosi ta pranojë plotësisht rekomandimin e Komitetit Drejtues të Konventës së Bernës për të mos financuar projektet hidrologjike në parkun e Mavrovës për rreziqet ekologjike, sidomos për rezikun që i kanosej faunës, florës, biodiversitetit të rajonit të Radikës, si dhe parkut të Mavrovës.

Kjo përbën një fitore të rëndësishme për gjithë shoqërinë civile në Maqedoni dhe Shqipëri dhe sidomos për komunitetin dibran në Shqipëri dhe Maqedoni të cilët i kanë kundërshtuar me prova dhe kanë argumentuar me fakte e evidenca ndaj projekteve që nga viti 2011 kur u prezantua ideja e tyre.

Si pasojë e ankesës bërë nga organizata jo-qeveritare ekologjike Eco Svest, komiteti i Konventës së Bernës vendosi të shqyrtojë projektet në parkun e Mavrovës dhe të kryente një verifikim në terren në qershor të 2015.

Kuadri ligjor ndërkombëtar dhe ai rajonal, konkluzionet e misionit të Konventës së Bernës mbështetën të gjitha shqetësimet ngritur nga organizatat ambientaliste të Maqedonisë, ato ndërkombëtare si dhe njëkohësisht pranuan si të vlefshme shqetësimet e komuniteteve të ndikuara nga këto projekte.

Bibliografia

- Prof. dr. Kadiu, Arian, “Dibra e Madhe dhe një vështrim në Dibrën e Vogël”, botur nga Morava, 2010; fq.16;
- Economic Commission for Europe – The Water Convention: serving the planet, 2013;
- United Nations Economic Commission for Europe – Botimet për legjislacionin, 2015;
- River Basin Commissions and Other Institutions for Transboundary Water Cooperation, 2009 – UNECE
- Marrëveshje ndërmjet qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, mbi çeshtjet e ekonomisë ujore, 5 dhjetor 1956’
- Protokolli i mbledhjes së dytë të jashtëzakonshme të komisionit shqiptaro-jugosllav për ekonominë ujore, 17 korrik 1962;
- The Drin: A Strategic Shared Vision, 2013
- Environment Without Borders – Balkan Vital Graphics;
- Ligj nr.93/2015 “Për Turizmin”;
- Ligj nr.9048, date, 07.04.2003”Për Trashëgiminë Kulturore”.